

VENDIM
Nr. 565, datë 15.7.2026

PËR PROCEDURËN E SHPALLJES PUBLIKE TË PASURIVE KULTURORE,
QË ZBULOHEN NË DET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 154, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e procedurës së shpalljes publike të pasurive kulturore, që zbulohen në hapësirën detare nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Qëllimi i këtij vendimi është:

a) garantimi i një procedure të unifikuar për shpalljen publike të pasurive kulturore që zbulohen në det, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar;

b) sigurimi i koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për identifikimin, dokumentimin e shpalljen publike të pasurive kulturore të zbuluara në det;

c) sigurimi i transparencës dhe informimit publik mbi zbulimin e këtyre pasurive.

3. Në kuptim të këtij vendimi:

a) “shpallja publike” është procesi zyrtar i publikimit të informacionit për pasurinë kulturore të zbuluar në det, pas përfundimit të procedurave të dokumentimit, verifikimit, deklarimit dhe regjistrimit, sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim informimin e publikut e garantimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nënujore;

b) “zbulim” është çdo identifikim, rastësor ose gjatë ushtrimit të veprimtarive të autorizuara, i një objekti ose i objekteve në grup me vlerë potenciale pasuri kulturore nënujore.

II. PROCEDURA E SHPALLJES PUBLIKE TË PASURIVE KULTURORE QË ZBULOHEN NË DET

1. Shpallja publike e pasurive kulturore, që zbulohen në det, kryhet pas përfundimit të procedurave të dokumentimit, verifikimit, vlerësimit, deklarimit dhe regjistrimit të pasurisë kulturore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Procedura e shpalljes publike përfshin:

a) njoftimin e zbulimit;

b) vlerësimin e interesit kulturor të objektit/objekteve në grup;

c) regjistrimin në regjistrin publik të vlerave kulturore materiale në administrim të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore në administrim të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;

ç) informimin e publikut, në përputhje me interesin shkencor e publik, pa cenuar sigurinë e pasurisë së zbuluar;

d) publikimin e informacionit në mjetet dhe në format e përcaktuara në këtë vendim.

3. Shpallja publike e pasurive kulturore, që zbulohen në det, kryhet vetëm pasi të jenë përmbushur kushtet e mëposhtme:

a) dokumentimi paraprak;

b) garantimi i integritetit dhe i sigurisë fizike të pasurisë;

c) përfundimi i proceseve të dokumentimit, verifikimit, deklarimit të interesit kulturor dhe regjistrimit në regjistrat publikë të pasurive kulturore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore. Regjistrimi në regjistrat publikë kryhet duke përdorur formatin e kartelës sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ç) zbatimi i masave paraprake të mbrojtjes;

d) kryerja e studimit shkencor paraprak dhe publikimi i rezultateve të studimit në organe ose në revista shkencore të specializuara.

4. Në çdo rast, shpallja publike nuk lejohet nëse gjendja e pasurisë paraqet rrezik degradimi, dëmtimi të mëtejshëm ose nëse kjo shpallje cenon sigurinë e pasurisë kulturore.

5. Çdo person fizik ose juridik, që zbulon, rastësisht ose gjatë veprimtarive të autorizuar, pasuri kulturore në det, ka detyrimin të njoftojë brenda 48 (dyzet e tetë) orëve autoritetin portual përkatës. Ky i fundit njofton Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) përgjegjëse.

6. Njoftimi përmban të dhëna mbi vendndodhjen, rrethanat e zbulimit dhe përshkrimin paraprak të objektit, sipas formularit tip, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Deri në ndërhyrjen e autoriteteve përgjegjëse të njoftuara, subjekti që ka kryer zbulimin është i detyruar:

a) të ruajë gjendjen e pasurisë në vendndodhjen e gjetjes;

b) të mos ndërmarrë veprime, që cenojnë integritetin e saj.

8. Zhvendosja e pasurisë lejohet vetëm kur është e domosdoshme për garantimin e sigurisë së saj ose të personave dhe, në çdo rast, vetëm me autorizim nga institucionet kompetente të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për trashëgiminë kulturore. Këto institucione, në rastet kur zhvendosja e pasurisë kulturore nënujore përfshin ndërhyrje në shtratin e detit ose veprimtari, që mund të ndikojnë në statusin e mjedisit detar, informojnë edhe institucionet përgjegjëse për burimet ujore dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

9. Në rastet kur pasuritë kulturore nënujore zbulohen nga institucione apo subjekte të autorizuar për veprimtari arkeologjike nënujore, raportimi kryhet pranë institucioneve të specializuara dhe organeve vendimmarrëse përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

10. Pas marrjes së njoftimit, IKTK-ja, në bashkëpunim me DRTK-në kompetente, institucionet përgjegjëse për sigurinë në det dhe me Institutin e Arkeologjisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, kryen verifikimin paraprak të pasurisë së zbuluar. Verifikimi paraprak shoqërohet me dokumentimin teknik, fotografik e gjeohapësinor të pasurisë.

11. Institucionet përgjegjëse për sigurinë në det, gjatë kryerjes së inspektimit, marrin masa të menjëhershme, për:

a) ruajtjen e integritetit të pasurisë;

b) parandalimin e dëmtimit, të zhvendosjes ose të grabitjes.

12. Dokumentimi paraprak është kusht i domosdoshëm për vijimin e procedurës së mëtejshme të shpalljes publike.

13. Pas marrjes së njoftimit dhe dokumentimit paraprak mbi potencialin e interesit kulturor të pasurisë së zbuluar në det, IKTK-ja, në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, vijon me procedurën e verifikimit të interesit kulturor, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

14. Në rast vërtetimi të interesit kulturor, deklarimi i pasurisë kulturore të zbuluar kryhet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

15. Pasuria e deklaruar regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore në administrim të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe në Regjistrin Publik të Vlerave Kulturore Materiale në administrim të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

16. Shpallja publike përmban:

- a) emërtimin e pasurisë kulturore;
- b) kategorinë ose tipologjinë e saj;
- c) përshkrimin e përgjithshëm;
- ç) rëndësinë historike, kulturore, arkeologjike ose shkencore;
- d) fotografi dhe materiale të tjera ilustruese;
- dh) informacionin mbi masat e mbrojtjes e të ruajtjes, kur kjo nuk cenon sigurinë e pasurisë.

17. Informimi i publikut bëhet nëpërmjet:

- a) publikimit në faqet zyrtare të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- b) publikimit në faqen zyrtare të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore;
- c) publikimit në platformat elektronike zyrtare;
- ç) formave të tjera të komunikimit publik, që mund të përfshijnë edhe:

i. publikimin e rezultateve të studimeve shkencore në organe shkencore të specializuara dhe në revistat e Institutit të Arkeologjisë të Akademisë së Shkencave;

ii. ekspozimin brenda dhe ose jashtë vendit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

18. Në çdo rast, informimi i publikut bëhet duke respektuar parimin e mosrrezikimit të pasurisë kulturore. Nuk publikohen të dhëna që mund të cenojnë mbrojtjen, integritetin ose sigurinë e pasurisë kulturore, veçanërisht koordinatat e sakta, të dhënat teknike, që mund të lehtësojnë lokalizimin ose nxjerrjen e paligjshme të pasurisë, informacione të tjera që, sipas vlerësimit të institucioneve kompetente, mund të favorizojnë grabitjen, trafikimin ose dëmtimin e saj.

19. Kufizimi i informacionit publik nuk pengon publikimin e të dhënave të nevojshme për informimin e publikut për ekzistencën dhe rëndësinë e pasurisë kulturore.

20. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore siguron përditësimin periodik të informacionit publik, në rast se studimet e mëtejshme sjellin të dhëna të reja për pasurinë kulturore.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Në rastet e zbulimit të pasurive kulturore me karakter ndërkufitar ose me rëndësi ndërkombëtare, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në koordinim me ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, bashkëpunojnë me shtetet përkatëse dhe organizmat ndërkombëtarë, sipas parashikimeve të Konventës së UNESCO-s për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore, Paris 2001, dhe Guidës Operacionale për zbatimin e saj.

2. Në rastet kur pasuria kulturore e zbuluar ndodhet brenda një zone të mbrojtur detare ose kur veprimtaritë e vlerësimit, të studimit apo të ndërhyrjes zhvillohen në zona të mbrojtura detare, zbatohen edhe kërkesat e procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për zonat e mbrojtura.

3. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ministria përgjegjëse për mbrojtjen, ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për infrastrukturën, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Instituti i Arkeologjisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe subjektet e licencuara për veprimtari arkeologjike nënujore, si dhe subjekte të licencuara për veprimtari të tjera në hapësirat detare të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCA 1

FORMULAR RAPORTIMI¹

¹ Mosraportimi në organet kompetente, sipas neneve 159 e 160, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore

NË RAST ZBULIMI TË PASURISË KULTURORE NË HAPËSIRAT DETARE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PJESA I
TË DHËNA PËR RAPORTUESIN

1. Emri, Mbiemri:	
2. Numri personal/NIPT-I (nëse subjekt juridik):	
3. Adresa:	
4. Telefoni:	
5. Email-i:	
6. Subjekti përfaqësues (nëse aplikohet):	
7. Marrëdhënia me zbulimin:	☐ Zbulues i drejtpërdrejtë ☐ Kapiten anijeje ☐ Zhytës ☐ Operator peshkimi ☐ Kompani infrastrukture detare ☐ Tjetër: _____

PJESA II
TË DHËNA MBI ZBULIMIN

1. Data e konstatimit:	dita ____ /muaji____/viti____
2. Ora e përafërt:	____ ____ AM/PM
3. Koordinatat në sistemin gjeodezik zyrtar, KRGJSH:	N(X): _____ E(Y): _____
4. Thellësia e përafërt (metra):	Z(h) _____

dhe muzetë”, të ndryshuar, përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës. Personi përgjegjës për ruajtjen e përkohshme të gjetjes mban përgjegjësi, sipas këtij ligji, nëse nuk përmbush detyrimin për ruajtjen e gjetjeve deri në verifikimin nga institucionet përgjegjëse.

5. Zona detare:	☐ Ujëra të brendshme ☐ Deti territorial ☐ Zonë ekonomike ekskluzive
6. Përshkrim paraprak i gjetjes: (lloji i objektit, materiali, përmasat, gjendja e ruajtjes, numri i objekteve, nëse janë disa)	

PJESA III RRETHANAT E ZBULIMIT

1. Aktiviteti gjatë të cilit u konstatua zbulimi:	☐ Peshkim ☐ Zhytje rekreative ☐ Kërkim shkencor ☐ Punime infrastrukturore ☐ Operacion detar ☐ Tjetër: _____
2. A është ndërhyrë mbi objektin?	☐ Po ☐ Jo Nëse po, përshkruani veprimin e kryer:
3. A është zhvendosur objekti?	☐ Po ☐ Jo
4. A ekziston rrezik i menjëhershëm dëmtimi?	☐ Po ☐ Jo Nëse po, specifikoni natyrën e rrezikut:

PJESA IV DOKUMENTACION BASHKËNGJITUR (në rast se disponohet)

- ☐ Fotografi
☐ Video
☐ Hartë me koordinata në sistemin referues gjeodezik zyrtar, KRGJSH ose *screenshot* me informacion për vendndodhjen
☐ Skicë përshkruese
☐ Të dhëna sonar/skanim nënujor
☐ Tjetër: _____

PJESA V DEKLARATË

Unë, i/e nënshkruari/a, emër _____ mbiemër _____, me numër identifikimi: _____, deklaroj se informacioni i dhënë është i saktë, sipas dijenisë sime, dhe se nuk kam kryer asnjë veprim të paautorizuar mbi objektin e raportuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

Data: ____ . ____ . ____

Nënshkrimi: _____

UDHËZIME PËR DORËZIMIN

- Formulari dorëzohet pranë autoritetit portual më të afërt, i cili njofton menjëherë Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe drejtorinë rajonale të trashëgimisë kulturore përgjegjëse.

- Raportimi duhet të kryhet brenda 48 orëve nga koha e zbulimit apo mbërritja në portin e parë.

SHTOJCA 2

KARTELË INVENTARIZIMI/REGJISTRIMI PËR TRASHËGIMINË KULTURORE NËNUJORE²

Vendndodhja					
Rajoni, Bashkia					
Autoriteti përgjegjës					
Regjistruar nga (emër/mbiemër, pozicioni)		Data		Email-i /tel.	
Emri i sitit				Numri i regjistrimit	

KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË SITIT			
TIPI	☐ Anije e mbytur ☐ Avion i rrëzuar ☐ Mjet tjetër ☐ Artefakte të veçuara ☐ Sit prehistorik ☐ Strukturë ☐ Shpellë ☐ Tjetër	Identifikim i konfirmuar	Po/Jo
		Periudha ose viti i krijimit/ ndërtimit	
		Periudha ose viti i mbytjes (mbulimit nga uji)	
		Gjendja e ruajtjes (konservimit)	

² Në zbatim të përcaktimeve të pikës 6, të nenit 60, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar, për kartelën e parashikuar në këtë dispozitë është marrë për referencë “Fletëmodeli i inventarit për trashëgiminë kulturore nënujore” (UNESCO model inventory sheet for underwater cultural heritage), i Guidës Operacionale për zbatimin e Konventës së UNESCO-s për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore, Paris 2001, në të cilën shteti shqiptar ka aderuar me ligjin nr. 10027, datë 11.12.2008, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore, Paris 2001”.

		☐ Gjendje e shumë e mirë (optimale) ☐ Gjendje e mirë ☐ I dëmtuar ☐ I shkatërruar
Përshkrim i gjetjeve		
VENDNDODHJA		
KOORDINATAT NË SISTEMIN NDËRKOMBËTAR UTM		KOORDINATAT NË SISTEMIN REFERUES GJEODEZIK ZYRTAR
Sistemi i Referencës	WGS 84	Sistemi i Referencës
X		N (X)
Y		E (Y)
Z		Z (H)
A janë verifikuar këto koordinata?		

SHTRIRJA MAKSIMALE E SITIT	Gjerësia		Gjatësia		Lartësia	
<i>(e saktë/e përafërt në metra)</i>						
PËRSHKRIMI	ZONA (EVIDENTO)		ZONA DETARE (EVIDENTO)			
	☐ Shpellë/zgavër e përmytur nënujore ☐ Bregdet detar ☐ Port ☐ Gji ☐ Afër bregut (të specifikohet distanca e përafërt) ☐ Larg bregut (të specifikohet distanca e përafërt) ☐ Det i hapur		☐ Tokësore ☐ Ujërat e brendshme ☐ Ujërat e brendshme detare ☐ Det territorial, ujëra arkipelagu ☐ Zona ngjitur ☐ Zona ekskluzive ekonomike ☐ Shkëmbina (shelfi) kontinentale ☐ Zona ndërkombëtare (deti i lartë) ☐ Zona ngjitur e një shteti tjetër ☐ Zona ekskluzive ekonomike e një shteti tjetër ☐ Shkëmbina (shelfi) kontinentale e një shteti tjetër			
UJËRAT	KARAKTERISTIKA TË UJIT		THELLËSIA NË M			
	☐ I qetë ☐ I valëzuar ☐ I trazuar		☐ Vlera maksimale			
			☐ Vlera minimale			
			SHIKUESHMËRIA			

<i>Site Immersion</i>	Me intervale	E vazhdueshme	E PJESSHME		E PLOTË	
-----------------------	--------------	---------------	------------	--	---------	--

PËRBËRJA/STRATIGRAFIA E SIPËRFAQES SË FUNDDETIT

Bar (barishte) deti		Zhavorr / gurë të vegjël		Gurë të rrumbullakët / gurë të vegjël		Shkëmb	
Rërë		Baltë (llum)		Blloqe shkëmbore		Tjetër	
Ekspozim/ sipërfaqe e ekspozuar	Pjesë të vendndodhjes të dukshme Nuk ka pjesë të dukshme Vendndodhja e dukshme si kodër/ngritje në reliev Tregues i vendndodhjes përmes sinjalit sonar				Aksesi	Nga bregu Me anije/me varkë	

(Shto skicën e vendndodhjes)

ARTIFAKTET ARKEOLOGJIKE

TIPI I ARTIFAKTIT TË GJETUR			
VENDNDODHJA AKTUALE	E Ruajtur (përcakto ku?)	Ekspozuar	<i>In Situ</i>

KONSERVIMI DHE RUAJTJA (sipas raporteve, etj.)

SFONDI HISTORIK, ORIGJINA KULTURORE			
ORIGJINA	Evropiane	RËNDËSIA	Historike Kulturore Artistike Arkeologjike
	Afrikane		
	Aziate		
	Arabe		
	Amerikane		
	Australiane	Dokumentacion historik	
	Tjetër (specifiko)	Referenca të tjera	

(Shto përshkrim të sfondit historik)

KËRCËNIMET

VEPRIMTARI QË DËMTOJNË SITIN	☐ Grabitje/shkatërrim për përfitim ☐ Rikuperim i ngarkesës ☐ Zhvendosje ☐ Shkatërrim i qëllimshëm ☐ Ekspozim ☐ Tjetër	VEPRIMTARI NJERËZORE QË NDIKOJNË NË SIT	☐ Nxjerrja e mineraleve ☐ Ndotje ☐ Peshkim me rrjetë tërheqëse ☐ Peshkim ☐ Gërmime/gërmim i funddetit ☐ Punime ndërtimi ☐ Ndryshimi i rrjedhave/struktura e rrymave ☐ Ndërtimi i digës ☐ Tjetër
FAKTORE NATYRORE, QË SHKAKTOJNË DËMTIM	☐ Erozion/shkëputje ☐ Ekspozim ☐ Ndikimi i oksigjenit ☐ Aktivitet sismik ☐ Valë ☐ Tjetër	STATUSI: ☐ Kërcënim në vazhdim ☐ Rrezik i menjëhershëm ☐ Kërcënim i pritur	
Tregues/evidenca të kërcënimeve:			
GJETJA, ZBULIMI			
Zbulimi	Data e zbulimit		
	Zbuluar nga:		
	Kontakte (në rast se aplikohet)		
Raporte	Dërguara nga (<i>pls underline</i>)	Drejtuar (<i>pls underline</i>)	
	☐ Gjetësi ☐ Anije, shtet ☐ Autoriteti përgjegjës lokal ☐ Arkeologu përgjegjës, menaxheri i sitit ☐ Autoriteti kombëtar përgjegjës	☐ Autoriteti kombëtar përgjegjës ☐ Ministria ☐ Shtet tjetër ☐ Shtetet palë të Konventës 2001 ☐ Tjetër	
Njoftimi	Dërguar nga:	Drejtuar	

UNESCO-s (<i>për sitet jashtë ujërave territoriale dhe nëse zbatohet</i>)	Autoriteti kombëtar përgjegjës tjetër	UNESCO Autoriteti Ndërkombëtar i Funddetit
DEKLARIM TË	MARRË NGA, DATA	NDJEKUR

INTERESIT	1.	
	2.	

VEPRIMTARI TË DREJTUARA NDAJ SITI				
Lloji i aktivitetit (hulumtim paraprak, dokumentim, rikuperim artefaktesh, gërmime...)	Datat e filli mit	Rezultatet	Subjekti përgjegjës	Kontakte
1.				
2.				Shto më tej
Ngarko	Raporte; foto; leje			
VEPRIMTARI TË PARACAKTUARA DHE KËRKESA PËR AUTORIZIM (nëse zbatohet)				
Lloji i veprimtarisë së paracaktuar	Data e fillimit	Veprimtaria e planifikuar	Subjekti përgjegjës	Kontakte
1.				
2.				Shto (sipas rastit)
Statusi i autorizimit	Emri dhe kualifiki met e drejtuesit të ekipit	Raportuar nga:	Drejtuar:	
		☐ Autoriteti përgjegjës lokal ☐ Arkeolog ☐ – Menaxheri i Sitit ☐ Personi ose entiteti që kërkon leje	☐ Autoriteti Kombëtar kompetent ☐ Ministria përgjegjëse ☐ Shtet tjetër ☐ Të gjitha shtetet palë të Konventës 2001 ☐ Autoriteti Ndërkombëtar i Funddetit ☐ UNESCO	
Njoftimi i UNESCO-s (për sitet jashtë ujërave territoriale dhe nëse zbatohet)		Dërguar nga:	Drejtuar	
		Autoriteti kombëtar përgjegjës, tjetër	UNESCO Autoriteti Ndërkombëtar i Funddetit	

INVENTARIZIMI DHE STATUSI ZYRTAR				
A është siti i regjistruar në inventarin kombëtar?				
Status i veçantë?				
Pjesë e një zone të mbrojtur?				
PUBLIKIMI DHE RAPORTE (RAPORTIME)				
Autorësia	Viti, vendi	Titulli	Link	Botimi, faqe